



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2019:268032

Datë: 20.02.2020

Numri i dokumentit: 00843151

P.nr.1010/19

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm, më Gjyqtarin Ferki Xhaferi, duke vendosur në lëndën penale ndaj të pandehurit A. M. nga Vushtrria, rr. "I. Q.", për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 te KPRK-es, duke vendosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti përgjithshëm PP.II nr.2952/19, te dt. 14.11.2019, dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor të paraqitur në Aktakuze, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 11.12.2019, merre këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm PP.II nr.2952/19, te dt. 14.11.2019 dhe kjo Gjykate i jep këtë:

URDHER NDESHKIMOR

I akuzuari;

A. M., nga i ati H. i lindur me dt...., ne Vushtrri, tani me banim ne Vushtrri Rr. I. Q. ku edhe jeton, shqiptare, shtetas i Republikës se Kosovës, me numër personal 1251181477,

ËSHTË FAJTORE

SEPSE: Me dt.19.11.2017, ne ora 15:50 min. ne pyllin shoqëror qe menaxhohet nga Drejtoria e mbrojtjes se mjedisit dhe pyjeve-sektori i pylltarisë-zyra ne Vushtrri, ne regjionin ekonomik pyjor te fsh.S. ne vendin e quajtur "R.", pa leje e me qellim vjedhjeje, është zënë duke prerë drunjtë 9 trungje ne sasi te përgjithshme prej 4.86m³, te llojit ahu me diametër 26-37 cm, te gjatësisë 15 metra ku vlera e dëmit është prej 656.10€,

Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 te KPRK-ës.

Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 41, 46, 73 te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, te KPP-se i;

S H Q I P T O N

DENIM MË GJOBË ne shumë prej 400€ (katërqind euro), te cilin dënim do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do te veproje ne baze te nenit 46 te KPRK-se, deri ne zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke llogaritur 20€ për një ditë të kaluar me burg.

I akuzuari obligohet që në emër të shpenzimeve procedurale – paushallit gjyqësor të paguaj shumen prej 20€, dhe 30€ në emër të kompensimit të viktimave të krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar të i kompensojë dëmin e shkaktuar në shumë prej 656.10€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m i

Prokuroria Themelore në Mitrovicë Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II nr.2952/19, të dt. 14.11.2019, së bashku me kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, kundër të pandehurit A.M. nga Vushtrria, tani me banim në Vushtrri rr. I. Q., për shkak të veprës penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-ës.

Gjykata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar në baze të nenit 495 të KPPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, pasi që nga shkresat e lëndës vërtetohet se ka prova të mjaftueshme, të cilat vërtetojnë fajësinë e të akzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë sipas Aktakuzës së Prokurorit të Shtetit.

Gjykata, vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë provat të cilat janë të mjaftueshme e për të vërtetuare fajësinë e të pandehurit, se ka kryer veprën penale e për të cilën ngarkohet, sipas aktakuzës së prokurorisë, kjo vërtetohet nga provat si vijojnë dhe atë nga fletëparaqitja e Drejtorisë së pyjeve, dt.19.11.2017, raporti mbi vlerën e shkaktuar dt. 04.12.2017 që konstaton vlerën prej 656.10€, të gjitha këto vërtetojnë veprimet në kuptim të veprës penale me të cilën akuzohet i pandehuri.

Sipas KPRK-së, vepra penale Vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, denimi për këtë veprë penale është denim me gjobe apo burgim deri në një (1) vite.

Gjykata në përputhje me nenin 73 të KPRK-së, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me gjobë, duke vlerësuar rrethanat lehtësues se është i gjendje se dobët ekonomike, ndërsa si rrethanë rënduese mori dëmin e shkaktuar palës së dëmtuar, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar është në proporcion me peshën e veprës penale, pasi që me këtë dënim pritet që të arrihet qëllim i ndëshkueshmërisë e përcaktuar me ligj sipas nenit 41 të KPRK-ës, pasi që njëra nga qëllimet e dënimit është të parandalojë kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të beje rehabilitimin e tij dhe se të përmbajë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, duke vlerësuar se i pandehuri do të përmbahet nga veprime të paligjshme, në mos shkaktimin e dëmit me veprime të natyrës së njëjtë, në të kundërtën gjykata e ka njoftuar me pasojat ligjore, andaj gjykata ka vlerësuar se edhe me një dënim të tillë do të arrihet efekti dhe qëllim i dënimit i parapare me ligj, në parandalimin e personave të tjerë në kryerjen e veprave penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komfor nën nenit 450 të KPP-ës.

Në mbështetje të nenit 458 e lidhur me nenin 463 të KPP-së, është vendosur edhe për kërkesën pasurore juridike.

Nga theksimet e theksuara si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE DEGA NE VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal

P.nr.1010/19 dt.11.12.2019

Gjyqtari i vetëm gjykues

Ferki Xhaferi

Numri i lëndës: 2019:268032
Datë: 20.02.2020
Numri i dokumentit: 00843151

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala ka te drejtë kundërshtimi, ne afat prej 8 (tete) ditësh, nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtrohet kësaj gjykate.